

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E martë, 4 korrik 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur.

7 Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem thërrisni çështjen.

8 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Kjo është çështja KSC-BC-
9 2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Ju lutem së pari do ju kërkoja që të paraqisni kush është
13 i pranishëm në sallën e gjyqit në seancën sot.

14 Z. Prokuror, keni ju fjalën.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Për Prokurorinë
16 janë Line Pedersen, Gaia Pergolo dhe Filippo de Minicis.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Mbrojtësi i Viktimave.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Unë
20 jam Simon Laws, Mbrojtësi i Viktimave për këtë çështje.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 Mbrojtja e të akuzuarit.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

25 Jemi këtu me z. Shala që na ndjek me videolidhje. Unë jam z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 Gilissen. Kemi po ashtu në seancë dhe dy ekspertët e tjerë
2 znj. Leto Cariolou dhe Hedi Aouini, Judit Kolbe është po ashtu
3 këtu si sekretare dhe ky është ekipi i Mbrojtjes së z. Shala.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Shala, a konfirmon që më dëgjon mirë? Z. Shala më dëgjon?

6 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj shumë
7 mirë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit, z. Shala.

10 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit William
11 Goodwin. Z. Goodwin është ekspert i thirrur nga Zyra e
12 Prokurorit të Specializuar.

13 Përpara sesa të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit, do të
14 jap dy urdhra gojarisht.

15 Urdhri i parë gojarisht ka të bëjë me një version publik
16 të redaktuar, i cili duhet të dorëzohet në pajtim me urdhrin
17 tonë, që është parashtrimi i protokolluar 538, për vendimin
18 për kërkesën e Prokurorisë për njoftim gjyqësor për fakte të
19 njohurive të përgjithshme. Ne kemi urdhëruar palët që të
20 japin, të dorëzojnë, pra, i kemi urdhëruar të premtën e shkuar
21 dy palët që të dorëzojnë versionet e redaktuara të
22 parashtrimit të protokolluar me numër 507. Deri tani nuk kemi
23 marrë asnjë dokument, kështu që dëshirojmë që t'i kërkojmë ose
24 e udhëzojmë Mbrojtjen që deri të premtën e ardhshme, më datë 7
25 korrik, të mund të dorëzojë versionin e redaktuar publik të

1 parashtrimin 507, sa i takon redaktimeve që janë bërë tashmë
2 nga ZPS-ja, domethënë, është një urdhër për mbrojtjen e të
3 akuzuarit.

4 Ky është urdhri i parë i dhënë gojarisht.

5 Urdhri i dytë i dhënë gojarisht ka të bëjë me kërkesën që
6 u parashtrua nga Mbrojtja dje, që është, pra, që ka të bëjë me
7 kërkesën e djeshme datë 3 korrik, që ka të bëjë me dy
8 dokumente të tjera, të cilat kërkoj që të shtohen në listën e
9 provave materiale që do të përdoren për dëshmitarin sot.

10 Dokumentet kanë numër identifikimi më poshtë. Do t'i them
11 ngadalë. Pra janë dokumentet DPS00237 deri në DPS00287,
12 dokument tjetër, është DPS00259 deri në DPS00269. Janë
13 dokumente të cilat janë nxjerrë dje si pjesë e paketës 139.

14 Mbrojtja parashtron se këtë kërkesë e ka bërë pas
15 konsultimeve me ekspertin mjekoligjor. E dimë që palët e tjera
16 nuk kanë ngritur ndonjë kundërshtim, pra, as Prokuroria dhe as
17 Mbrojtësi i Viktimave. Kështu që autorizojmë që këto dokumente
18 të mund të shtohen në listën e provave materiale që do të
19 përdoren për të marrë në pyetje Dëshmitarin 04872.

20 Ky është urdhri i dytë gojarisht.

21 Në qoftë se nuk keni ndonjë gjë tjetër për të ngritur apo
22 për të diskutuar me Trupin Gjykes mund të vazhdojmë tani me
23 dëshminë e dëshmitarit.

24 Z. Goodwin, do të dëshmojë këtu në sallën e gjyqit pa
25 masa mbrojtëse. Mund të vazhdojmë të procedojmë siç kemi bërë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 4

1 me dëshmitarë të tjerë, për shembull, të kalojmë në seancë
2 private në qoftë se është e nevojshme që të mbrohet identiteti
3 i dëshmitarëve të tjerë dhe viktimave të tjerë që janë në
4 rrezik për shkak të bashkëpunimit të tyre me ZPS-në.

5 Për sot, kemi organizuar tre seanca prej një orë e gjysmë
6 secila. Nuk parashikoj që të bëj ndonjë ndryshim në kalendarin
7 e ditës së sotme, megjithatë le të shikojmë si do të vazhdohet
8 dhe çfarë rezultati do të kemi.

9 Znj. Sekretare, ju lutem, a mund të sillni dëshmitarin në
10 sallën e gjyqit?

11 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
12 këshillohen]

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Mirëmëngjes.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
18 se erdhët në Dhomat e Specializuara të Kosovës.

19 Z. Shala, a e dëgjon dëshmitarin?

20 I AKUZUARI: [Përkthim] Po, e ndëgjoj mirë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Z. Goodwin, si jeni sot?

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Shumë mirë. Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të

1 fillojmë sot z. Goodwin, me dëshminë tuaj por përpara sesa të
2 fillojmë kam disa komente për të bërë.

3 Jeni thërritur që të jepni dëshmi nga ZPS-ja në çështjen
4 Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës për të ndihmuar
5 Trupin Gjykues që të arrijë një vendim. Së pari do t'ju
6 kërkojmë që të bëni betimin solemn të dëshmitarit dhe më pas
7 do t'ju bëhen pyetje nga prokurorët e ZPS-së, më pas do t'ju
8 bëj pyetje Mbrojtësi i Viktimave dhe më pas Avokati i
9 Mbrojtjes. Edhe Trupi Gjykues mund t'ju bëj pyetje si dhe mund
10 të bëhet një raund i dytë i pyetjeve në qoftë se do të kenë
11 palët, përfshi këtu edhe Trupin Gjykues.

12 Dëshiroj t'ju jap disa udhëzime sa i takon përgjigjes së
13 pyetjeve që do t'ju bëhen.

14 Z. Goodwin, dëgjoni me kujdes pyetjet që ju drejtohen.
15 Nëse nuk e kuptoni pyetjen, lirisht mund t'i kërkonit palës
16 përkatëse që t'ju bëjë pyetjen përsëri, t'jua sqarojë pyetjen
17 ose ta përsërisni atë. Duam që ju të jepni ekspertizën tuaj në
18 mënyrën më të mirë të mundshme mbështetur në gjetjet dhe
19 konstatimet e ekspertizës.

20 Ju lutem përgjigjuni pyetjeve që ju bëhen. Në qoftë se
21 kemi nevojë për sqarime të mëtejshme do t'ju bëhen pyetje të
22 tjera shoqëruese.

23 Më lejoni t'ju jap edhe disa këshilla praktike dhe këto
24 janë si më poshtë, çdo gjë që thoni këtu përkthehet dhe
25 regjistrohet për procesverbal. Kështu që është e rëndësishme

1 që të flisni pranë mikrofonit, të flisni ngadalë dhe të flisni
2 qartë.

3 Ajo çfarë është shumë e rëndësishme, është gjithashtu që
4 ju të filloni të flisni pasi ka përfunduar pyetjen ose ka
5 përfunduar së foluri personi që ju bën pyetjen. Është e
6 rëndësishme për ne, për të mos pasur folës që flasin në të
7 njëjtën kohë. Mbase mund t'ju vijë në ndihmë që të numëroni me
8 kokën tuaj, me mendjen tuaj deri në pesë në mënyrë të tillë që
9 të jeni të sigurtë që çdo gjë është përkthyer dhe është
10 zbardhur.

11 Në qoftë se ngre dorën, kjo do të thotë që duhet të
12 pushoni së foluri. Dhe, domethënë, zakonisht e bëjmë me shenjë
13 në mënyrë të tillë që të mos flasim në të njëjtën kohë. Për
14 këtë arsye ngre dorën dhe këtë merrni si shenjë që nuk duhet
15 të vazhdoni më tej.

16 Mund të ndodhë që t'ju kërkoj që të dilni nga salla e
17 gjyqit në qoftë se është e nevojshme që të diskutohet diçka
18 lidhur me një pyetje që ju bëhet Në mënyrë të tillë që të
19 shmangim ndikimin nga pala pyetëse.

20 Në qoftë se keni pyetje, në qoftë se keni nevojë për
21 pushim ose në qoftë se ka ndonjë gjë tjetër që doni të ndani
22 me Trupi Gjykses ju lutem ngrini dorën dhe ne do t'ju
23 plotësojmë kërkesën.

24 E kuptuat të gjithë këtë?

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
2 shoh që pohoni me kokë.

3 Tani dua t'ju kërkoj që të bëni betimin solemn të
4 dëshmitarit. Sekretarja do t'ju ndihmojë. Dhe dua t'ju kujtoje
5 që është vepër penale në juridiksionin e DSK-së në qoftë se
6 jepni dëshmi të rreme. A e kuptoni këtë?

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, e kuptoj.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull mund të lexoni betimin solemn.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
11 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
12 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
13 vetëm të vërtetën dhe nuk të mbajë të fshehtë asnjë gjë për të
14 cilën kam dijeni.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
16 rregull. Faleminderit, dëshmitar.

17 Tani do të fillojmë me marrjen tuaj në pyetje nga
18 avokatët e Prokurorisë.

19 Prokurori na e ka thënë sesa kohë do të marrë për marrjen
20 tuaj në pyetje.

21 Kështu që e keni ju fjalën, z. Prokuror.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
23 Gjykatës.

24 DËSHMITARI: WILLIAM GOODWIN

25 Pyetje nga Z. De Minicis: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 8

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

2 PY. Mirëmëngjes, profesor.

3 PË. Mirëmëngjes.

4 PY. Profesor a mund të na thoni si quheni dhe emrin mbiemrin
5 për procesverbal?

6 PË. Unë quhem William Goodwin.

7 PY. Kur dhe ku keni lindur?

8 PË. Kam lindor më 21 maj 1969. Dhe vendi i lindjes është
9 Stoke, në Mbretërinë e Bashkuar.

10 PY. ju na keni dorëzuar një curriculum, një CV tënden që
11 përmban në hollësi studimet, anëtarësimet profesionale,
12 gjithashtu edhe profesionet që keni mbajtur në të shkuarën dhe
13 çfarë pune bëni aktualisht si dhe botimet që keni bërë. Nuk do
14 t'ju pyes në hollësi me ato çfarë keni raportuar si pjesë e
15 curriculumit tuaj, por dua që t'ju bëj disa pyetje të
16 përgjithshme për të kuptuar se çfarë formimi profesional keni?

17 Profesor, unë e di që ju aktualisht jepni mësim në
18 Universitetin e Lankashërit, apo jo, është kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, në Central Lancashire është emri i universitetit?

21 PË. Po.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të paraqitet në ekran
23 curriculumi i ekspertit. Është dokumenti me numër identifikimi
24 ERN 103392-103400 RED.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 9

1 paraqiteni dokumentin, z. Sekretar.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem zmadhojeni pak.

3 PY. Profesor, lexoj se sa i takon pozicionit aktual është:

4 Lexues i Gjenetikës Mjeko-Ligjore dhe thuhet që jepni mësim në

5 lëndën e ADN-së Forenzike dhe Profilizimi është Master

6 Shkencor për Shkenca Forenzike ose Mjekoligjore, Shkolla e

7 Shkencave Natyrore.

8 Ju lutem a mund të na thoni se me çfarë merret kjo

9 shkencë pra, shkenca forenzike ose mjekoligjore?

10 PË. E përshkruaj veten si gjenetist mjekoligjor. Dhe kjo

11 është një fushë e cila ka të bëjë me aplikimin e biologjisë

12 molekulare në çështje mjekoligjore, zakonisht, domethënë, që

13 kanë të bëjnë me identifikimin e provave që mbeten në vendin e

14 krimit ose përkimin e tyre të dyshuarve dhe unë jam i

15 specializuar në veçanti lidhur me lidhjen, me përcaktimin e

16 lidhjes ose marrëdhënies ndërmjet personave që jetojnë dhe

17 personave të vdekur.

18 PY. Në fakt, iu i përgjigjët edhe pyetjes time pasardhëse,

19 domethënë, që nëse si pjesë e karrierës tuaj profesionale keni

20 punuar për identifikimin e testimin të lidhjes, pra, të

21 farefisnisë.

22 PË. Po. Në punën që kam bërë më përpara në Universitetin e

23 Glasgout kam punuar për të përcaktuar ose vërtetuar

24 marrëdhënien nëpërmjet testeve laboratorike dhe këtu janë

25 përfshirë çështje, për shembull, çështje që kanë të bëjnë me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 10

1 anëtarë të publikut me forcat e policisë, po gjithashtu dhe me
2 agjenci të cilat kanë të bëjnë me identifikimin e viktimave të
3 fatkeqësive.

4 PY. A ju është kërkuar nga ndonjë zyrë për të vërtetuar ose
5 për të krahasuar dy ADN të identifikuara, domethënë, a keni
6 përvojë apo jeni të njohur me metodat specifike të cilat
7 përdoren në laboratorin çek në dy raportet të cilat ju kemi
8 kërkuar që t'i analizoni.

9 PË. Po. Metodologjia e përdorur në dy raportet është një
10 metodologji shumë standarde që përdoret në gjenetikën
11 mjekoligjore dhe jam i njohur me mënyrën ose metodat që
12 përdoren në të dyja raportet.

13 PY. Profesor, nuk do t'ju kërkoj që të përsërisni
14 informacionin që, në fakt, është dhënë në raportin e shkruar
15 prej jush por dua që të filloj duke ju kërkuar që t'i
16 vërtetoni që ato janë raportet tuaja dhe do të bëj gjithashtu
17 edhe disa pyetje pasuese për të kuptuar më mirë.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që të
19 paraqitet raporti i parë i hartuar nga profesor Goodwin për
20 arsye të vërtetimit të tij prej dëshmitarit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
22 lutem të vazhdoni.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Numri identifikimit është ERN
24 103373 deri në 103387 RED.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 11

1 Prokuror, besoj që do ishte mirë që ta ulni pak ritmin, të
2 flisni më ngadalë.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Faleminderit.

4 PY. Zotëri, ky është raporti që keni përgatitur për ne në
5 korrik të vitit 2021. Domethënë, kjo është data e letrës së
6 udhëzimeve. Ky raport përmban opinionin tuaj mbi disa
7 identifikime të ADN-ve. Vetëm njëri prej tyre është i
8 rëndësishëm për këtë çështje specifike, ndërkohë që
9 informacioni tjetër është redaktuar sepse nuk ka të bëjë me
10 viktima që lidhen me çështjen në shqyrtim.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dëshiroj t'i kërkoj Sekretarit
12 të Gjykatës që të kalojë tek faqja 15 e këtij raporti, pra, ta
13 paraqesë këtë në ekran.

14 PY. Profesor e shohim emrin tuaj këtu. Ju lutem na thoni a
15 është nënshkrimi juaj ky që është mbi emrin dhe datën e
16 raportit?

17 PË. Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet
19 që të presim të paktën pesë sekonda nga momenti që ju bëhet
20 pyetja derisa të jepet përgjigja sepse po flasim në anglisht
21 ndërmjet njeri-tjetrit, por na duhet që z. Shala të marrë
22 përgjigjen. E kuptoj që mbase është pak e vështirë, po duhet
23 të përshtatemi.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Duhet ta mbajë dhe unë parasysh
25 këtë gjë. Është hera e parë që bëjmë pyetje-përgjigje me një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 12

1 dëshmitar që flet të njëjtën gjuhë si ne, pra, në anglisht.

2 PY. Së pari më lejoni t'ju pyes. A i ke hartuar vetë këto
3 raporte?

4 PË. Po.

5 PY. Faleminderit. Tani dëshirojmë të kalojmë tek raporti
6 tjetër që keni përgatitur për ZPS-në në vitin 2023. Është një
7 raport më i shkurtër sesa ai i pari dhe ka të bëjë vetëm me
8 një çështje specifike që lidhet me këtë lëndë gjyqësore.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem, a mund të paraqitet
10 në ekran dokumenti ERN 111160 deri në 111162?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
12 lutem, vazhdoni.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

14 PY. Profesor, sikurse mund ta shihni në faqen e parë të këtij
15 raporti, pra, ngjitur me viktimën është një emër. Këtë emrin
16 nuk do ta themi në seancë të hapur. Unë këtij personi do t'i
17 drejtohem në qoftë se është e nevojshme, pra, do t'i drejtohem
18 si subjekti C dhe do ju kërkoja që të bënit të njëjtën gjë dhe
19 ju në përgjigjet tuaja.

20 Në këtë raport, juve ju kërkohet që të jepni pikëpamjet
21 tuaja për një përditësim të raportit të institutit çek, që për
22 procesverbal është dokumenti me numër identifikimi, ERN
23 110670-110674, që përmban llogari ose kalkulime të reja të
24 profileve ADN dhe të ekstraktuara nga kampionët që ju vunë në
25 dispozicion laboratorit çek në vitin 2009.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 13

1 Profesor, a e keni përgatitur ju këtë raport?

2 PË. Po.

3 PY. Kam disa pyetje të tjera pasuese.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
5 korrigjim për procesverbal, z. Prokuror. Vërej që në faqen 10,
6 rreshti 8, raporti mban datën 2003, por kam përshtypjen që
7 bëhet fjalë për raportin e 2023 apo jo?

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Po, data e raportit është
9 viti 2003.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 rregull. Kjo ta tani u sqarua për procesverbal. Ju lutem
12 vazhdoni më tej.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

14 PY. Nëse mund të kalojmë tek faqja 2 e raportit. Në faqen 2
15 të këtij raporti, ju thoni që analiza e kromozomit Y i shton
16 peshë hipotezës që subjekti A - dhe subjekti A është emri i
17 parë nga të dy emrat në paragrafin e parë që pamë së bashku
18 pak më herët - është babai biologjik i personit nga i cili
19 është marrë kampioni i kockës ose të paktën lidhet përmes
20 lidhjes së babait paternal. Po për shkak të faktit që
21 kromozomi përkatës, pra, kromozomi Y nuk ishte i dhënë
22 raportin e parë.

23 Dhe për këtë arsye duhet t'ju bëj këtë pyetje: Më datë 27
24 qershor 2023, ju dhashë të dhënat e përdorura për kromozomin
25 Y. A e keni pasur mundësinë që të shikoni të dhënat e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 14

1 dorëzuara prej nesh?

2 PË. Po.

3 PY. Pas analizimit ose këqyrjes së këtyre të dhënave, akoma
4 jeni i mendimit që analiza e kromozomit Y i shton peshë
5 hipotezës që subjekti A është babi biologjik i personi nga i
6 cili është marrë kampioni nga kocka?

7 PË. Po.

8 PY. Mbështetur te të dhënat e kromozomit Y dhe llogaritjeve
9 përkatëse, a jemi në gjendje që të jepni ndonjë vlerësim të
10 shkallës së mbështetjes që mbështet përputhshmërinë e
11 kromozomit Y që jepet në raportin e përditësuar?

12 PË. Kam bërë disa analiza në mënyrë të tillë që të kemi një
13 përfundim më të konsoliduar të këtij kërkimi ose përputhjeje.

14 PY. Në raportin e bërë në institutin çek, u përcaktua
15 marrëdhënia e gjasave, që unë e kuptoj, që kalkulimi i
16 kromozomeve Y është bërë sipas një mënyre tjetër ose është një
17 lloj tjetër kalkulimi i këtyre kromozomeve. Dhe ndërkohë
18 gjasat e bëjnë lidhjen biologjike të qenësishme në qoftë se
19 bëhet fjalë për më tepër sesa 11 milion herë krahasueshmëri.
20 Është kështu apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. A është e mundur që të bëhet një, domethënë, a jemi në
23 një linjë sa i takon asaj çfarë jepet në raportin e
24 laboratorit dhe asaj çfarë thoni juve?

25 PË. Pranohet që kromozomi Y sillet ndryshe në kromozome të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 15

1 tilla kështu që rezultatet mund të jenë të kombinuara, kjo
2 mund të shtojë peshë për sa i takon ngjashmërisë ose raportit
3 të ngjashmërisë origjinale. Mënyra sesi bëhet kjo varet shumë
4 nga komuniteti mjekoligjor. Dhe fakti është që kromozomi Y nuk
5 shikon vetëm thjeshtë marrëdhënien ose përkulshmërinë e
6 marrëdhënies ndërmjet fëmijës dhe babait, po gjithashtu edhe
7 lidhjen ndërmjet fëmijëve të tjerë apo të afërmeve të tjerë.

8 Pra, me fjalë të tjera është ekziston një mënyrë për të
9 vlerësuar shpeshtësinë e kromozomit Y të paraqitur nga
10 laboratorit çek. Ndërkohë metoda përgjithësisht e pranuar nga
11 komuniteti mjekoligjor ose të paktën një prej këtyre metodave
12 është që të përdoret një bazë e të dhënave që është baza e të
13 dhënave YHRD dhe kjo është një bazë e të dhënave e cila bën të
14 mundur hedhjen e studimeve të ndryshme të cilat përcaktojnë
15 hollësitë e shpeshtësisë të kromozomit Y në popullsi të
16 ndryshme.

17 PY. A do ishte e mundur për ju që në qoftë se do të
18 kombinohej raporti i gjasave që jepet në raportin e
19 laboratorit çek me përlllogaritjet e kromozomit Y dhe kësaj
20 qasjeje më konservative si do të prekej numerikisht kjo
21 marrëdhënie e gjasave ose ky raport i gjasave?

22 PË. Kur kam kërkuar në YHRD, në këtë bazë të të dhënave, unë
23 kam përdorur një popullsi si targin ose objektivin tim,
24 domethënë, kam përdorur kromozomet Y të pjesës së popullsisë
25 jugperëndimore që prefshin, për shembull, Ballkanin, Italinë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 16

1 jugore, në mënyrë të tillë që të mund të shihet shpeshtësia
2 dhe një numër i përafërt që ka dalë deri në 2830. Pra, ajo
3 çfarë kam bërë është që kam përdorur thjesht atë qasjen më
4 konservatore. Domethënë, rezultati që kam marrë ka qenë 1 me
5 180 individë.

6 Pra, mënyra sesi bëhet kombinimi varet nga laboratorë të
7 ndryshëm, nga politika që përdoren nga laboratorë individualë.
8 Pra, unë mendoj që një qasje konservatore do të ishte që të
9 përdorej një rritje prej dhjetëfish, domethënë, kjo do ta
10 rriste rreth në 11 milion.

11 Dhe në qoftë se bëjmë kombinimin e shpeshtësisë së
12 shfaqjeve atëherë një qasje konservative do të ishte një
13 rritje 100-fish që do të çonte në raportet e gjasave prej 1 në
14 1 miliard.

15 Z. AOUINI: [Përkthim] Ndjesë, të nderuar Gjykatës. Më
16 duket se nuk kemi një mospërputhje me raportet e
17 përkueshmërisë sepse mendoj se shifrat që kemi në raport janë
18 të ndryshme nga ato që u tha nga eksperti. Ndoshta do të ishte
19 mirë të sqarohen këto shifra.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, z. Avokat i Mbrojtjes. I kam mbajtur shënim edhe
22 unë vetë për veten time.

23 Kështu që, z. Prokuror, a mund të shohim numrin 2850 dhe
24 180 për t'u siguruar që këto janë shifrat u përmendën nga
25 dëshmitari.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 17

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

2 PY. Z. Dëshmitar, në transkript në faqen 13, rreshti 12,
3 thuhet që shpeshtësia e përkueshmërisë ishte 1 në 2830,
4 ndoshta ky nuk është numri që keni thënë juve. Nuk e di në
5 qoftë se mund të na e sqaroni?

6 PË. Kur shohim bazën e të dhënave, me këtë profil të gjerë të
7 kromozomit Y shohim një përkim me 1 me 280, 283 individë
8 besoj.

9 Megjithatë kur aplikojmë korrigjime statistikore dhe kur
10 bëjmë interpretimet më konservatore shifrat shkojnë
11 mesatarisht 1 me 180 përkime. 1 me 180 individë domethënë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

15 PY. Na thatë që duke kombinuar dy raporte të ngjashmërisë apo
16 proporcionit të ngjashmërisë për të arritur në qasje
17 konservatore arrini në një proporcion të ngjashmërisë që është
18 dhjetë herë më i madh. Por shfrytëzon këto qasje konservatore
19 që e rrit këtë me 100 herë.

20 Komuniteti i shkencëtarëve a ka udhëzime përgjithësisht
21 të pranueshme të cilët mund të na ndihmojnë të kuptojmë sesi
22 mund t'i interpretojmë këto numra për të arritur një
23 identifikim? Pra, si mund të na ndihmoni në këtë drejtim?

24 PË. Ka shprehës gjuhësorë të proporcionit të ngjashmërisë të
25 cilët lehtësojnë pikërisht mënyrën e interpretimit të këtyre

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 18

1 numrave, shifrave. Është një organizatë që quhet MC që është
2 një rrjet i instituteve mjekoligjore të Evropës ku gjendet
3 udhëzuesi sesi ky proporcion i ngjashmërisë të mund të
4 shprehet në mënyrë gjuhësore.

5 PY. Po të shohim proporcionin e ngjashmërisë së raportit çek
6 dhe ta kombinoni atë me përlllogaritjet e kromozomit Y, atëherë
7 duke shfrytëzuar këto udhëzime si mund ta klasifikojmë?
8 PË. Çdo shprehje e shifrave mbi 1 milion e mbështet këtë ide
9 në mënyrë shumë të fuqishme. Udhëzuesi ndalon pikërisht tek
10 shifra 1 milion nuk trajton asgjë sipër shifrës 1 milion.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk kam më pyetje të tjera.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të sqaroj për procesverbal.
13 Pasi avokati më ka quajtur profesor, më ka bërë nder duke më
14 quajtur profesor, por, në fakt, unë nuk jam profesor, thjesht
15 nuk jam profesor, quhem studiues.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Për momentin kanë përfunduar pyetjet nga Zyra e
19 Prokurorit të Specializuar. Tani do të vazhdojmë me Mbrojtësin
20 e Viktimave dhe do t'i kërkoj atij nëse ka pyetje.

21 Z. LAWS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nuk kemi pyetje
22 për të bërë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Faleminderit.

25 Tani do t'ia jap fjalën palës Mbrojtëse.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. De Cariolou

Faqe 19

1 Z. Goodwin, tani do t'ju bëjë pyetja Avokatja e palës
2 mbrojtëse.

3 Pyetje të palët tjetër nga Znj. Cariolou:

4 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

5 PY. Mirëmëngjes.

6 PË. Mirëmëngjes. Unë jam Leto Cariolou dhe do t'ju bëj disa
7 pyetje lidhur me raportet e ADN-së që janë paraqitur në këtë
8 çështje gjyqësore dhe pyetjet do t'i bëj në emër të z. Shala i
9 akuzuari.

10 Fillojmë. Në raportin e 2009 të cilin e keni analizuar në
11 faqen 3.

12 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Që është në shifrën
13 SITF000124557.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Vazhdoni. Ta vendosim në ekran, ju lutem.

16 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Kalojmë në faqen 3 të këtij
17 raporti. Faleminderit.

18 PY. Këtu shikohet sesi fragmenti i eshtrës dhe po citoj
19 "ishte në gjendje shumë të dëmtuar" dhe që kishte shumë gjasa
20 dhe citoj "që eshtrat kanë kaluar në procesin e sapunifikimit
21 dhe i është bërë -- janë bërë disa analiza për nxjerrjen e
22 këtij materiali gjenetik të ADN-së i cili ka arritur në
23 profile të pjeshme".

24 Pyetja që kam unë është që është e mundur të arrijmë në
25 konkluzionin që sasishtë e ADN-së kanë qenë shumë të vogla dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. De Cariolou

Faqe 20

1 ka qenë e dëmtuar shumë?

2 PË. Po. Me aq sa shoh këtu ky supozim është i qëndrueshëm,
3 pra, që ADN-ja të ketë qenë e dëmtuar dhe në sasi shumë të
4 vogla.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
6 mund, ju kërktoj që të prisni ca sekonda ju lutem përpara se
7 t'u jepni përgjigjen pyetjeve që ju bën Avokatja e Mbrojtjes
8 pasi kjo do të na ndihmojë me përkthimin. Faleminderit.

9 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
10 Gjykatëse

11 PY. A mund të konfirmoni që sasi të vogla të ADN-së dhe
12 dëmtimi i ADN-së mund të çojë në dështim për gjetjen e disa
13 aleleve që janë të pranishme në këtë profil të ADN-së për të
14 cilin flasim?

15 PË. Po, është e mundur. Mund të ketë humbje të të gjithë
16 treguesve të ADN-së apo një humbje të pjeshme të këtyre
17 treguesve.

18 PY. Po pres që të përfundojë përkthimi.

19 A mund t'i shpjegoni avokatëve që humbja apo ulja e
20 numrit të aleleve siç bëhet me analizën mjekoligjore?

21 PË. Rënia e aleleve është që në rastet kur ne duhet t'i
22 shohim alelet por nuk i shohim ose për shkak të degradimit,
23 pra, dëmtimit ose për shkak se nuk ka pasur sasi të
24 mjaftueshme të ADN-së për këtë.

25 PY. A mund të na shpjegoni se kur vërehet rënia e aleleve?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. De Cariolou

Faqe 21

1 PË. Kjo ndodh kur ka ose ADN të dëmtuar në shkallë shumë të
2 lartë ose në rastet kur është në sasi shumë të vogla.

3 PY. Po pres të përfundoj përkthimi.

4 A mund të na komentoni lidhur me shfaqen e profileve të
5 mundshme në rastin kur ka rënie të aleleve dhe për sa i përket
6 identifikimit të eshtrave?

7 PË. Kjo ndodh herë pas here, por kjo duhet parë rast pas
8 rasti.

9 PY. A jeni dakord me mua që kjo ndodh rëndom me eshtrat,
10 mbetjet skeletore?

11 PË. Unë do të thosha që kjo varet nga rasti. Në disa raste ne
12 kemi nxjerrim profile shumë të mira nga eshtrat skeletore, në
13 raste tjera, jo.

14 PY. A mund të konfirmoni për këto fenomene në rastin kur ka
15 rënie të aleleve mund të ndodhë që të kemi një profil të ADN-
16 së të gabuar?

17 PË. Po, ka raste kur alelet dhe nuk janë të pranishme në këtë
18 profil.

19 PY. Të kalojmë tek raporti i 2023 që unë besoj që e keni
20 analizuar për të përpiluar raportin tuaj. Tani kalojmë në
21 faqen 11672.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Vazhdoni, Sekretaria.

24 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

25 PY. Aty kemi një tabelë të statistikave prindërore.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. De Cariolou

Faqe 22

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Prisni derisa të shfaqet në ekran kjo tabelë.

3 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Po kërkoj faqen 110672 që është
4 tabela e statistikave të prejardhjes që besoj ishte shtojcë e
5 raportit 2023.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ndoshta mund t'ju ndihmoj. Që
7 numri i plotë është 110670.

8 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 PY. Nëse mund të përqendrohemi tek lokusi i dytë D19S433,
10 pra, që është i dyti në këtë tabelë, shohim që këtu thuhet që
11 ka patur një alele, alelin 14. Nga informacioni i këtij
12 raporti a mund të përjashtohet për shembull, që profili i ADN-
13 së i fragmentit të eshtrës ka alelet 8 dhe 14, ndërkohë që
14 alelja 10 të mos jetë shfaqja? Ndodh një gjë e tillë?

15 PË. Po, ndodh, por skenari që paraqisni ju është i pa -- ka
16 shumë pak gjasa, pasi alelet e vogla kanë më pak gjasa që të
17 mos shfaqen sesa ato të mëdhatë. Nuk mund të them që është e
18 pamundur gjithsesi.

19 PY. A është e saktë të thuhet që ulja e numrit të aleleve
20 shfaqet në alelet e nivelit më të ulët?

21 PË. Lartësia më e madhe në këtë profil të ADN-së ndodh kur
22 kemi një rënie të atillë sa ne nuk e vëzhgojmë dot.

23 PY. A është saktë të thuhet që ky pragu i këtyre aleleve
24 është në këtë elektroferrogamë mund të arrijë në atë shifër ku
25 të mendohet që është e mundur që të ketë rënë në atë masë sa

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. De Cariolou

Faqe 23

1 nuk shikohet dot?

2 PË. Po, mund. Ka disa laboratorë të cilat mund ta
3 interpretojnë këtë në një mënyrë të atillë që të arrijnë edhe
4 në përkufizim është apo nuk është alele.

5 Por kjo ndodh me disa profile komplekse të ndërlikuara ku
6 interpretohen këto të dhënë pasi ekspertët interpretojnë nëse
7 ka apo nuk ka rënie të aleleve.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa
9 për procesverbal, pasi nuk e shoh që të jetë reflektuar në
